



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 8/17
Prishtinë, më 14.11.2017, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Ali Lajqi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku dhe Blerim Kuqi.

Munguan: Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Mytahirë Haskuka, Enverë Hoti dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza Ministere i MF, Lulzim Rafuna – këshilltar i MF.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luçjetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku.

R e n d i i d i t ë s

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt.24.10.2017;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-018 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për financim shtesë për Projektin për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Projektin e konkureshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim;**
- 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale;**
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016;**
- 7. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017;**
- 8. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt.24.10.2017;**

Kryetari – konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt.24.10.2017, miratohet pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-018 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për financim shtesë për Projektin për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Bedri Hamza – ministria e financave në muajin mars 2017 ka negociuar marrëveshjen financiare në formë kredie me Bankën Botërore në shumën prej 20.8 milion euro për projektin për bujqësi dhe zhvillim rural. Projekti është dizajnuar prej Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural me mbështetje prej Bankës Botërore. Implementimi i projektit pritet të zgjas 5 vite nga data e nënshkrimit të marrëveshjes. Projekti përbëhet nga këto pjesë: ngritja e kapaciteteve profesionale dhe teknike për sektorin rural në shumë 900,000 euro, rritja e investimeve përmes graveve 12.9 milion euro nga shuma totale, aktivitetet për skema të ujitjes për Radoniq e Dukagjin prej 6 milion euro.

Kushtet e kësaj kredie: shuma 20.8 milion euro është me kohëzgjatje 25 vite, maturiteti 5 vite. Kohëzgjatja e projektit është 20 vite dhe pagesat bëhen në 40 këste në dy gjysëmvetor, duke filluar nga viti 2022. Norma e interesit është 0,45% në shumën e tërhequr, tarifa e shqyrtimit është 0.755 në shumën e tërhequr, e tarifa e zotimit 0,5% vjetore në shumën e patërhequr. Projekti në fjalë kontribon në projektin e prodhimit, cilësisë së prodhimit e aftësive konkurruese në mes të aplikimit të standardeve të tregut, duke mundësuar punësime të reja në këtë fushë

Kryetari – pyeti se a është norma e interesit vjetor 1.25 apo 0.45%? Implikimet financiare fillojnë pas vitit 2022, siç ka vlerësuar edhe Departamenti i Buxhetit. Kësti i parë fillon me 15 nëntor 2022 dhe perfundon me 15 prill 2042, me 40 këste të pagesës.

Naser Osmani - pyeti grandet a konsiderohen si investime kapitale, sepse një kohë nuk i kemi konsideruar si investime kapitale? Ne e kemi pasur si qëllim se të gjitha kreditë që i marrim në këto kushte të favorshme që shkojnë në investime kapitale me i përkrah, ndërsa më herët kreditë, kryesisht janë shpenzuar për trajnime.

Bedri Hamza - sqaroi se grandet trajtohen si investime kapitale dhe rregullohet te tabela e buxhetit tek pjesa investimet kapitale përmes financimit të klauzolës së investimeve. Me shumë të drejtë deputet e keni ngritur këtë çështje, sepse ne tani e kemi kaluar fazën e asistencës teknike dhe jemi të koncentruar kryesisht për projekte kapitale, që në këtë rast është fusha e bujqësisë që është me prioritet për vendin.

Kryetari - po bëhet fjalë për një kredi të butë afatgjatë me normën e interesit që amortizohet me siguri prej inflacionit për atë periudhë. Unë kam biseduar edhe me Drejtorin e Bankës Botërore në Kosovë dhe kam kërkuar që të njoftojë komisionin në çdo kohë për marrëveshjet që ka me ministrinë në mënyrë që të jemi në rrjedha të bisedimeve.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.06/L-018 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për financim shtesë për Projektin për bujqësi dhe zhvillim rural ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Projektin e konkureshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim

Kryetari – bëhet fjalë për një marrëveshje prej 14 milion euro për periudhën 2017-2022, periudha e kthimit është 25 vite, grejs periudha 5 vite, amortizimi 20 vite dhe norma e interesit 1.2%.

Bedri Hamza – ministria e financave me 19 prill 2017 ka negociuar marrëveshjen financiare në formë kredie në shumën financiare prej 14.3 milion euro për projektin e konkureshmërisë dhe kujdesshmëria për eksport dhe të gjithë jemi përkrahës që bartëse e zhvillimit për ekonomi është sektori privat. Projekti është dizajnuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, ndërsa do të implementohet nga ministria e tregtisë dhe industrisë dhe ajo e bujqësisë. Ky projekt ka karakter zhvillimor që mundëson përfundimin dhe rritjen e bizneseve dhe përmes zhvillimit të mëtutjeshëm të kapaciteteve të institucioneve kombëtare të cilësisë, siç janë agjencia standardizimit dhe drejtoria e akreditimit. Implementimi i projektit pritet të zgjas 5 vite nga data nënshkrimit të marrëveshjes.

Projekti përbehet nga këto komponentë. Komponenta e parë përfshin përmirësimin e mjedisit e të bërit biznes dhe gadishmërisë për eksport me shumë prej 13.8 milion euro, përmirësimin e infrastrukturës kombëtare dhe cilësisë e mbështetjes së saj në normën ndërkombëtare 6.5 milion euro, ndërmarrjet e vogla e të mesme për përmirësimin e gadishmërisë për eksport 2.9 milion euro dhe reformimin e sistemit të bizneseve 4.4 milion euro. Komponenta e dytë përfshin mbështetja e implementuesve të projektit 0.5 milion euro. Kushte financiare të kësaj kredie janë të favorshme të iniciuare: shuma 14.8 milion euro me kohëzgjatje me 5 vite grejs periudhë, 20 vite amortizim me 40 këste gjysëm-vjeqare të pagesës. Norma e interesit është 0.45% me shumën e tërhequr dhe tarifa e shërbimeve 0.75, në shumën e tërhequr tarifa e zotimeve 0.5% vjetore.

Kryetari - me qenë se bëhet fjalë për kredi që është pak a shumë e ngjashme kushtet e kredisë paraprake, propozojë që ta votojmë projektligjin.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisionit unanimitisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin nr.06/L-017 për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për Projektin e konkureshmërisë dhe gatishmërisë për eksport ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale

Kryetari - qështja e kryesore e trajtuar në këtë projektligj është rregullimi i të drejtave dhe përgjegjësi, parimeve dhe masave doganore për veprim nga doganat e Kosovës për mallrat nga të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale.

Bedri Hamza – projektligji për masat doganore për të drejta e pronësisë intelektuale rregullon organizimin, veprimtarinë dhe kompetencat e Doganës. Po ashtu ky ligj percakton veprimet dhe masat doganore ndaj mallraave për të cilat dyshohet se shkelin të drejta e pronësisë intelektuale.

Ky projektligj qëllim kryesor ka të vendos mbrojtjen e sistemit efikas, transparent e të besueshëm, i cili është në pajtueshmëri me legjislacionin e ri të bashkimit evropian për mbrojtjen e procesit intelektual që do të jenë në përputhje me doganat e vendeve të BE-së, duke marr për bazë se ligji aktual i cili është në fuqi nuk mbulon të drejta e caktuara të pronësisë intelektuale dhe shkeljet e caktuara.

Me këtë ligj e kemi rregulluar formën më të thjeshtë të kërkesës për veprim doganor, përveç aplikimit të postës administrative, aplikohet një formular praktik për ushtrim të kërkesës për veprime. Gjithashtu për vazhdimin e afatit do të jetë një formë shumë e thjeshtë procedurale për aplikim. Pjesa e tretë rregullon procedurat e suspendimit, të lirimit të mallrave në qarkullim të lirë deri sa të kryhet verifikimi i origjinalitetit, procedurat e lejimit, të daljes në qarkullim të lirë të mallrave dhe procedurat e asgjësimit të mallrave. Projektligji, gjithashtu parasheh aplikim më të drejtë të procedurës së hijezuar dhe procedurës së rregullt. Pjesa e katërt parasheh përgjigjësitë e doganese e të drejtave e shpenzimet dhe sanksionet.

Kryetari – një ligj i domosdoshëm për Kosovën. Projektligji në fjalë nuk ka kosto buxhetore, por kam një pyetje në pjesën e dokumentit të memorandumet shpjeguese ku thuhet se ligji është në është pjesërisht në përputhje?

Naser Osmani – theksoi se qështja e përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së, do të vlerësohet nga komisioni përkatës për integritet evropiane dhe pastaj në shqyrtojmë rekomandimin e tij. Unë mendoj se duhet të mbështesim këtë projektligj që është i domosdoshëm për Kosovën për mbrojtjen e autorësisë vendore të kosovare dhe krijohen mekanizmat e sanksionimit. Unë e mbështes ligjin, që do ta plotësonim një kriter, por mendoj që nuk ka me qenë i zbatueshëm.

Bedri Hamza - e tha edhe deputeti se jemi të obliguar të procedojmë tutje me legjislacione dhe MSA na obligon që të hamronizojmë legjislacionin tonë me direktivat e BE-së. Ne duhet të ecim në ngritje të kapaciteteve që merren me implementimin e këtij ligji.

Kryetari – është një ligj i domosdoshëm sa i përket MSA-së, por sa kemi me pas suksese në implementim ta shohim. Na duhen kapacitete shtesë edhe në doganë për të luftuar kontrabandën dhe futjen e mallrave në të zezën.

Blerim Kuqi - përafërsisht deputeti Naseri i tha ato që dashta me thënë, por ne duhet me caktu mekanizma përcjellës që janë në harmoni me standardet e BE-së, por edhe me standardet e regjionit për implementimin e këtij ligji.

Bedri Hamza – qëllimi i ligjit është ajo që një kompani e cila ka drejtë me regjistru një mark tregtare dhe në rast të cenimit të kësaj marke, atëherë ligji ofron këtë garanci.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin nr. 06/L-015 mbi Masat Doganore për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intelektuale.

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016

Kryetari – Fondi i Kursimeve Pensionale për vitin 2016 ka pasur një rezultat pozitiv me investime bruto ose kthim pozitiv me 64.6 milion ose me 4.4% në çmimin e njësisë. Në këto rezultate kanë kontribuar 96.6% investimet e mjeteve në tregjet ndërkombëtare, prej këtyre kemi kthimin në bruto në 3.4%. Në termat e alokimit taktik të mjeteve në vitin 2016 ishte vit më aktiv që kishte pasur deri atëherë ky aktivitet rezultoi me me shitëblerje prej 7.8 milionë euro në tregjet financiare globale.

Përveç në tregjet globale Fondi plasoi gjatë vitit edhe 74 milion euro në tregun vendor, nga këto 20 milion në dispozita me afat, në tre banka BSPK, Banka Private Piznesit dhe TEB, dhe 54 milion në Thesarin e Kosovës.

Në përmbledhje është vit mjaft i kënaqshëm për përfomancë të investimeve për vitin 2016. Sa i përket treguesve tjerë kishte një rritje të kontributeve të grumbulluara për 10.2%. Po ashtu edhe numri i kontribuesve aktiv është rritur për 5.2% dhe deri në fund të vitit mjetet nën menxhimit të Fondit ishin ekuivalente me 23.7% të bruto produktit. Si sfidë e vitit 2016 për Fondin si një instucion i pavarur ishte që të gjitha aktivitetet e saj të prokurimit duhet të trajtoheshin nga agjencia qendrore e prokurimit, kjo erdhi si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit të prokurimit që solli vonesa serioze dhe ulje të efektivitetit në procesin e prokurimit.

Ymer Havolli – raportoi se llogaritë e hapura të reja në krahasim me vitin 2015, në 2016 janë 34,034 llogari të reja numri kontribuesve aktiv në vitin 2015 279000, ndërsa në vitin 2016 i kontribuesve aktiv ishte rreth 312,600. Të pensionuar gjatë viti 2015 i kemi pasur rreth 4,400, gjithashtu edhe gjatë vitit 2016 i kemi 4,400. Kemi shpërndarë 19 milion në vitin 2015 pensione, përsëri në vitin 2016 janë 19 milion. Prej themelimit deri sot i kemi të pensionuar që i servison fondi i kursimeve pensionale 33,400 ndërkaq në mjete i kemi 917,000. Kemi pasur diku kontribute të alokuara rreth 9 milion, klientë të shërbyer gjatë vitit i kemi rreth 85,000.

Vërshim Hatipi – sqaroi se letrat më vlerë të Kosovës kanë pasur kthim më të mirë sesa këto investime që po i quaj negative. Përgjatë viti 2016 bonot e Kosovës kanë pasur tendencë të rënies.

Ymer Havolli – Qeveria e Kosovës prej vitit 2012 përmes thesarit të Kosovës ka filluar të themeloj bonot të cilin ne mund ti fusim mjetet në Kosovë. Sigurisht që normat dhe kthimet më të mëdha pozitive që i kemi deri tani të cilat janë në vlerë jo të vogla po një pjesë e madhe cilat janë kryesisht nga investime e jashtme. Elementi kyq i investimeve deri në 30% e ka interesin e kontributëdhënave, atë interes ne jemi përpjek që ta harmonizojmë me barazëpeshen e bonove të qeverive të tjera nga rajoni.

Kryetari – si argument përmendet siguria, por nuk e di sa do e kishit përdorur në konkurrencë. Sa bënë peshë siguria e mjeteve më pas si kriter kryesor i investimit të mjeteve?

Adrian Zalli – sqaroi se qështja e këtyre mjeteve është e paraparë që në momentin kur paraqiten kontributëdhënsi, të kthehen bashk me rifitim në gjendjen aktuale të njësisë së fitimit edhe krejt akumulimi t’iu kthehet personave. Koha e kthyerjes së këtyre mjeteve do jetë deri më 31 dhjetor dhe do kalojnë në buxhetin e Kosovës.

Kryetari – propozojë që komisioni të rekomandoj Kuvendit për miratimin e raportit të punës së Fondit për Kurisime Pensionale për vitin 2016 pasi që i njëjti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga ligji i punës për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisionit unanimisht nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016.

7. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2017

Ymer Havolli - Pasi është shqyrtuar detaje buxhetin për i viti 2017 dhe pasi është përcaktu projeksioni në lëvizje munëshme nga rrjedha e parasë së FKPK-së, për vitin 2018 ne i kërkojmë Kuvendit të miratoj tarifat vjetore investive dhe operacionale. Tarifa për investime krahasuar për vitin 2018 është propozuar

0,381% nga 0.393% sa ishte në vitin 2017. Ndërkaq, tarifa për aktivitetet operacionale të Fondit është propozuar 0.071% nga 0.081% sa ka qenë në vitin 2017.

Treguesit kryesor për vitin 2017 janë inkurajues, deri më 8 nëntor 2017, kthimi nga investimet në këtë vit ka shkuar 94.5 milion euro, d.m.th. deri para disa ditësh ne kemi rreth 100 milion fitim ose një rritje të çmimit diku për 6%. Rolin kryesor në këtë performancë e ka zhvillimi pozitiv i tregjeve financiare globale. Nëse ruhet ky ritëm në fund të këtij viti dhe nëse shpresojmë se nuk do të ndonjë rënie rapide e qmimeve, Fondi do të kalojë shifren 400 milion euro të kthimit bruto nga investimet prej themelimit ose prej vitit 2003.

Kryetari – sa i përket taksës operacionale, njëren nga argumentet kryesore jepni se është më e ulta si përqindje e gjitha mjeteve. A mundeni me tregu se sa është përqindja e kësaj takse si përqindje e mjeteve që do të shtohen në fund, në vitin e ardhshëm?

Adrian Zalli - ne pretendojmë se viti 2018 do të fillojë me 1.6 milion, gjatë vitit do të këtë po ashtu edhe investime të paparashikueshme diku rrethë 3% apo 50 milion. Prej këtyre do të kontribuojnë kontributet e kontribuesve rreth 144 milion. Tërheqjen e kursimeve e atyre që do të dalin në pension do jenë 26 milion, nëse mbledhen gjitha këto do jetë mesatarja gjatë tërë vitit 1.7 milion.

Kryetari – propozojmë që ti rekomandojmë Kuvendit të miratojë kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale për caktimin e taksës së investimeve 0.381% dhe taksës operacionale prej 0.071%, për vitin 2018.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisionit me Katër vota Për, tre Abstenime dhe Asnjë Kundër, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandojë Kuvendit, të miratojë kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operacionale prej 0,071% dhe taksës investive prej 0,381%, për vitin 2018.

8. Të ndryshme

Kryetari – propozojë që Komisioni të angazhojë nga buxheti i Komisionit ekspertin znj. Merita Zogjani për analizën dhe shqyrtimin e Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018.

Kryetari konstatoi se me Komisioni miratoi propozimin për angazhimin e ekspertës, Merita Zogjani për analizën dhe shqyrtimin e Projektligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2018, e cila do të kompensohet për 23 ditë pune në pajtim me Udhëzimin për Administrimin e Buxhetit të Komisioneve.

Mbledhja përfundoi në ora 14:30

Përgatitur nga Staf mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lumir Abdixhiku

